



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK BERAT
Komisoni i Përhershëm për Ekonominë, Financën dhe Shërbimet Sociale

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: “Mbi miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit “Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 3 (Reload3)” si dhe metodologjisë për zbatimin e marrëveshjes”

Analiza ligjore: (bazueshmëria ligjore)

Propozimi mbështetet në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore “ i ndryshuar, ligjit 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore, Ligjit Nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ligjin nr.162, datë 23.10.2020 “Për Prokurimin Publik,” i ndryshuar,

Situata aktuale e funksionit(përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

Bashkia Berat është përfituese e projektit ReLOAD3 - Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor III.

Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 3 (ReLOaD3) është një iniciativë e financuar nga Bashkimi Evropian (BE) dhe e zbatuar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (PNUD). Ky program është vazhdim i nismës së mbështetur më parë - ReLOaD1 dhe ReLOaD2 të zbatuar në periudhën katër vjeçare 2017-2024.

Sikurse dhe në fazat e mëparshme të programit, objektivi specifik i programit është të forcojë bashkëpunimin midis bashkive dhe organizatave të shoqërisë civile (OSHC) në Ballkanin Perëndimor, të kontribuojë në një mjedis më mbështetës për OSHC-të, bazuar në financime publike transparente, një kuadër ligjor mbështetës, si dhe rritje të angazhimit civil në hartimin e politikave, zbatim dhe monitorim.

Palët kanë identifikuar aktivitetet e mëposhtme në të cilat mund të zhvillojnë bashkëpunimin, me secilën Palë që vepron si subjekt në zbatim të mandatit, rregulloreve, politikave dhe procedurave të veta:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

- i) Forcimin e bashkëpunimit midis bashkisë dhe organizatave të shoqërisë civile përmes zhvillimit të një modeli transparent dhe me bazë projekti i financimit të Organizatave të shoqërisë civile.
- ii) Forcimin e kapaciteteve të Bashkisë dhe OSHC-ve për dialog efektiv dhe zbatimin e skemave lokale të grantit;
- iii) Forcimin e shërbimeve të ofruara në përgjigje të nevojave të komunitetit vendor brenda Bashkisë Berat;
- iv) Kontributin në skemën e grantit bazuar në formularin e aplikimit dhe në letrën e interesit të Bashkisë Berat bashkëngjitur këtij memorandumi;
- v) Përgatitjen dhe zbatimin e (të paktën) një thirrje publike për projekte të OSHC-ve, të financuar plotësisht nga buxheti i bashkisë, brenda periudhës 2026-2028 duke përdorur metodologjinë LOD;
- vi) Shkëmbim direkt të njohurive midis qeverisjes vendore pjesëmarrëse, OSHC-ve dhe aktorëve të tjerë në nivel rajonal.

Situata financiare : Bazuar në këtë marrëveshje, do të ketë asistencë financiare për organizatat e Shoqërisë Civile, e cila do të jepet bashkërisht nga Bashkia Berat dhe Programi Reload III. Asistenca financiare do të lëvrohet sipas metodologjisë LOD e krijuar posaçërisht për Bashkitë.

Metodologjia LOD është një qasje metodologjike për alokimin transparent të fondeve publike për organizatat e shoqërisë civile. Kjo qasje synon të gërshetojë rekomandimet e Bashkimit Evropian (BE) për Menaxhimin e Ciklit të Projekteve (MCP) dhe udhëzimet e BE-së për vlerësimin e qasjeve të projekt-propozimeve, si dhe të sigurojë mjetet për shpenzimin efikas të fondeve publike. Një nga synimet kryesore të saj është të sigurojë cilësi të lartë në procesin e planifikimit dhe zbatimit të projekteve dhe njëtrajtësi në përdorimin e mjeteve dhe dokumentacionit për zbatimin e suksesshëm të projekteve të OSHC-ve.

Drejtoria / Sektori përgjegjës

Drejtoria e Integritimit Evropian dhe Projekteve, Drejtoria Juridike si dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave.

Impakti social / grupet që preken:

Metodologjia LOD është një qasje metodologjike për alokimin transparent të fondeve publike për organizatat e shoqërisë civile



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Metodologjia LOD është një udhëzues, ose një varg hapash që, në mënyrë të thjeshtë, gjithëpërfshirëse dhe fleksibël, shpjegojnë të gjithë procesin e financimit, përfshirë përgatitjen, menaxhimin dhe zbatimin e përzgjedhjes së projekt-propozimeve të OSHC-ve që mund të marrin fonde nga buxhetet publike në të ardhmen. **Metodologjia LOD** mbështetet në përvoja të pasura, mësimet të nxjerra dhe rekomandime me shembuj praktikë.

Komisioni i Përhershëm për “ **Ekonominë,Financën dhe Shërbimet Sociale**” , i mbledhur në datën 20/10/2025, shqyrtoi projekt vendimin “Mbi miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit “Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 3 (Reload3)” si dhe metodologjisë për zbatimin e marrëveshjes”

relacionin e dokumentat shoqërues propozuar nga Kryetari i Bashkisë dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash

VENDOSI

1. Të miratojë Marrëveshjen e Bashkëpunimit “Programi Rajonal Për Demokracinë Vendore Në Ballkanin Perëndimor 3 (Reload3)” si dhe Metodologjisë për Zbatimin e Marrëveshjes.

Komisioni i Përhershëm për Ekonominë,Financën dhe Shërbimet Sociale

Krenar Suku- Kryetar i Komisionit

Anisa Veliu –N/Kryetar

Endrina Tangu-Sekretar i Komisionit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Fatjon Elezi-Anëtar

Rovena Cuku-Anëtar

Muharem Hoxha-Anëtar

Shyqyri Dura-Anëtar

Datë 20 /10/2025